Inxh. i diol. i Ndërtimit të Avionëve Avdi J. Shala
Specialist i Hetimit të Sigurisë dhe Aksidenteve Ajrore

eMail: avdi.j.shala@gmail.com
Tel: 00377 44 876 883

Prishtinë, 27 prill 2016

Zyra e Kryeministrit
27 APR 2016
PRANUAR

I DREJTOHEM:

Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Isa Mustafa
Shefe e Stafit z. Vlora Dumoshi
Zëvendësshef i Stafit z. Valon Murtezaj
Shefit të Kabinetit z. Sokol Havolli
Sekretari i Përgjithshëm z. Fitim Krasniqi
Drejtori i Zyrës Ligjore z. Besim Kajtazi

LËNDA: Ankesë për shkelje të procedurave për riemërim "Anëtar i KHAIA-së

I nderuar Z. Kryeministër,

Të nderuar zonja dhe zotërinj,

Me vendimin nr. 05/84 te datës 15.04.2016, ju keni emëruar anëtarët e Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike. Unë kam qenë konkurrent, dhe me këtë rast ju drejtohem Ju, për të ju njoftuar, se nuk pajtohem me vendimin e lartcekur dhe se do t'i drejtohem gjykatës përkatëse me ankesën. "Shkelje e procedurave të aplikuara dhe manipulim i procesit të përzgjedhjes për (ri)emërimin e anëtarëve të Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike" në Zyrën e Kryeministrit të Republikës së Kosovës.

Personat, te cilët ju i keni emëruar, nuk e kanë kualifikimin e as përvojën time, që kërkohet me Ligjin për Aviacion Civil dhe standarde ndërkombëtare të aviacionit civil, të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

Që ju ta kuptoni më mirë, se në ç'farë rrethanash unë jam munduar ta japë kontributin tim në ndërtim te institucionit dhe të ardhmes së këtij vendi, e kam bashkangjitur një raport përmbledhës për mandatin tim të kaluar.

Me respekt

Avdi J. Shala

Bashkangjitur: Raporti i përmbledhur i zhvillimeve në KHAIA

Inxh. i dipl. **Avdi J.Shala**

Specialist i Hetimit të Sigurisë dhe Aksidenteve Ajrore

eMail: avdi.j.shala@gmail.com
Tel: 00377 44 876 883

Prishtinë, 12.02.2015

I drejtohem:

Kryeministrit të Republikës së Kosovës z. Isa Mustafa

Shefe e Stafit z. Vlora Dumoshi
Zëvendësshef i Stafit z. Valon Murtezaj
Shefit të Kabinetit z. Sokol Havolli
Sekretari i Përgjithshëm z. Fitim Krasniqi
Drejtori i Zyrës Ligjore z. Besim Kajtazi

Përmbledhje e zhvillimeve në KHAIA, nga themelimi i saj deri me sot

Te nderuara zonja dhe zotërinj!

Në përmbyllje të mandatit tim, Anëtar i Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA), Inspektor i Operimeve, e kam parë të arsyes, tua dërgoj një përmbledhje të zhvillimeve në KHAIA, që nga themelimi i saj e deri me sot!

Në mandatin tim, si anëtar i KHAIA-së, kontributi im ishte i fokusuar kryesisht në zhvillimin e aviacionit dhe funksionalizimin e këtij autoriteti, qe është më i larti në fushën e transportit, çfarë mund të shihet qartë në të gjithë punën dhe veprimtarin time, gjatë kësaj kohe. Përkundër këtij angazhim, prapë së prapë, shumë gjera nuk kanë lëvizur në drejtimin e duhur, dhe KHAIA ka ngecur shumë keq në kuptimin e funksionalizimit të tij. Me pak fjalë, mund ta them hapur, se KHAIA është shembulli më i keq i mundshëm i ndërtimit të një institucioni të lartë shtetërorë/shtetndërtimit!

Ka fakte të mjaftueshme, se problemet të cilat janë aktualisht prezent në KHAIA, zanafillën e kanë shumë më herët, për të mos thënë, qysh me themelimin e tij.

Në vijim në mënyrë të përgjithësuar dua t'i paraqes disa ngjarje qe kanë prekur direkt zhvillimin dhe funksionalizimin e mirëfilltë të KHAIA-së, qe nga themelimi i tij:

Themelimi i Komisionit për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA)

KHAIA është themeluar në bazë të "Ligjit për Aviacionin Civil të Kosovës" në Zyrën e Kryeministrit në qershor të vitit 2009. Siç kam mësuar, konkursi për anëtarët e parë të KHAIA-së është përsëritur tre (3) herë, pasi qe ICO atëkohë nuk e kishte dhënë aprovimin për anëtarët e propozuar, sepse komisioni për përzgjidhen e tyre kishte propozuar persona të pakualifikuar dhe të papërshtatshëm! Çuditërisht, pas çdo përsëritje të konkursit, prapë kishin dalë të njëjtit emra të propozuar, derisa ICO, përkundër vërejtjeve qe i kishte, kishte pranuar, por me kushtin qe të ketë të paktën një anëtar të kualifikuar në fushën e aviacionit. U zgjodhën anëtarët e parë të KHAIA-së: Kreshnik Gashi (inspektor i Inxhinierisë Aeronautike), Arben Gashi (Inspektor i Incizuesve) dhe Armend Verbovci (Inspektor i Operimeve).

Më vonë mësova, se dy të paret, Kreshnik dhe Arben Gashi kishin qenë personat, për të cilët ICO kishte kritikuar, sepse nuk e plotësonin asnjë kriter për ta marr detyrën e caktuar në KHAIA, ndërsa Armend Verbovci me par e kishte ushtruar profesionin e Kontrollorit të Trafikut Ajrorë në ANP "Adem Jashari", por qe ky kishte pranuar te vinte në KHAIA, vetëm nëse i mundësohet ta ketë pagën e njëjtë dhe të punontë kohë pas kohe si Kontrollor, sa për ta mbajtur licencën, ç'fare cilësohet konflikt interesi në këtë detyrë.

Unë jam kthyer nga Gjermania në shtator të vitit 2009 për të parë mundësin e angazhimi tim në ndonjë institucion në fushën e aviacionit në Kosovë. Gjatë bisedimeve qe pata, kuptova se ka mundësi te angazhohem si hetues në KHAIA, dhe për këtë qellim, atë kohë kam pasur një takim me këshilltarin e Kryeministrit, Lirim Greiçevci, i cili me pat thënë, se mua do të më takoj mbështetja nga fondi për kuadro dhe se rroga ime do të ishte diku rreth 1600 €, ndërsa me konkurs, veç pozitës Inspektor i Operimeve me ishte caktuar edhe kryesimi i KHAIA-së. Çuditërisht, pas marrjes së detyrës, unë kuptova, se kryesimin e KHAIA-së ia kishin lënë Kreshnik Gashit, e poashtu as shtesën nga Fondi për Kuadro nuk e pash kurrë! Kjo me bëri të kuptoj, se aty nuk duhej fare përvoja ime profesionale por vetëm CV-ja ime me certifikatat përcjellëse, sa për t'ia mbyllur gojën ICO-së dhe auditorëve ndërkombëtar.

Me pak fjalë, e gjithë kjo, le të kuptohet, se ky autoritet nuk ishte themeluar për të bërë ndonjë punë të mirë në zhvillimin e aviacionit në Kosovë, për ç'farë edhe duhej.

Rasti i draft-ligjit "hetimi i aksidenteve në aviacion dhe hekurudha"

Qysh në vitin 2010, KHAIA kishte përgatitur një draft të ligjit për Hetimin e Aksidenteve Ajrore, por pikërisht në atë draft kishte pasur një përpjekje nga ish-kolegu Kryesues i KHAIA-së, Kreshnik Gashi, për t'ia lenë vetes çdo kompetencë (Mund të cilësohet, si një përpjekje e tij për ta privatizuar KHAIA-në!). Unë, pasi e vërejta një gjë të tillë, iu drejtova me eMail Zyrës Ligjore (e mesa mbaj mend, edhe Sekretarit të Përgjithshëm, Z. Fitim Krasniqi). Në vend qe draft-ligji në fjalë të përmirësohej dhe të procedohej për miratim, ai ishte bllokuar dhe nuk u mor askush më me të, derisa në vitin 2012, mungesa e një ligji të tillë ishte dal rekomandim në Raportin e Progresit nga BE-ja. Në vitin 2012, me ligjin për Hekurudhat, tanimë KHAIA-së i kishin kaluar kompetencat edhe për hetimin e aksidenteve hekurudhore, çfarë u mor në konsideratë në ri-hartimin e draft-ligjit, tani për Hetimin e Aksidenteve Ajrore dhe Hekurudhore, i cili u përgatit deri në detajin e fundit, por, pa ndonjë shpjegim, prapë u bllokua nga persona të caktuar, dhe sot e asaj dite nuk u përmend më, e KHAIA mbeti pa legjislacionin e duhur, i cili do t'ia hapte rrugën këtij autoriteti për tu zhvilluar dhe funksionalizuar (Unë e kam përgatitur një punim me vlera shkencore, se si do të duhej të riorganizohej KHAIA-ja, qe të ishte njëherë e mirë e plote dhe funksionale, dokument të cilin ia kam protokolluar direkt Kryeministrit dhe Sekretarit të Përgjithshëm, si rekomandim për ta riorganizuar KHAIA-në, me 18.06.2013. Fatkeqësisht, deri me tani nuk kam parë ndonjë ndryshim si rezultat i atij rekomandimi. Mund ta gjeni në arkiv!). Poashtu, me ligjin për Hekurudhat e Kosovës, me Nenin 31, ishte paraparë të angazhohej një person i kualifikuar, i cili do të merrej me hetimin e sigurisë dhe aksidenteve hekurudhore. Edhe pse prej 2012-tës, kur KHAIA-së iu deleguan kompetencat, kanë ndodhur një numër i konsiderueshëm i aksidenteve hekurudhore me fatalitet, në të cilat kanë humbur jetën një numër i konsiderueshëm i qytetareve tanë, ende nuk është punësuar hetuesi i paraparë.

Mos publikimi i raporteve të sigurisë

Në fakt, mos-funksionalitetin e KHAIA-së e dëshmon edhe kjo, se deri me tani, edhe pas pesë (5) viteve ekzistimi të KHAIA-së, nuk është publikuar as edhe një raport i vetëm sigurie, edhe pse kemi pasur disa raste, për të cilat ne kemi hapur hetim, bile unë personalisht, qysh në qershor të vitit 2012 e kam përgatitur raportin finalë të aksidentit me paragllajd në Fushën Ajrore të Mirenës, e të cilin raport, atëkohë, ia kam dërguar me email për komentim dhe procedim tutje dy kolegëve të mi, Kreshnik e Arben Gashit. E për çfarë arsye, këta të dy e kanë bllokuar publikimin e këtij raporti, asnjëherë nuk e kamë kuptuar. I vetmi qe do ndihej keq nga publikimi i raportit në fjalë, do të ishte Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës, sepse pikërisht ky raport ka

pasur një varg rekomandimesh të sigurisë, të cilat i janë drejtuar AACK-së. Vallë, a mos ishte kjo arsyeja?!

Mungesa e pajisjeve personale e teknike për hetim

Veç kësaj, edhe pse KHAIA është një autoritet i pavarur garantuar me ligj, e qe bënë pjesë në grupin e autoriteteve për ndërhyrje emergjente, çfarë hetuesit në rast aksidenti menjëherë duhet te nisën për në vendngjarje, dhe kjo pa marr parasysh, a është ditë apo natë, verë apo dimër, se a është vendngjarja në një fushë apo në majëmali, hetuesit duhet të jen sa me shpejt aty. E për ta mundësuar një gjë të tillë, ata patjetër qe duhet ta posedojnë të paktën një automjet të përshtatshëm dhe t'i kenë te gjitha pajisjet e nevojshme teknike dhe personale në të. Kanë kaluar vitet qe kur unë e kam përgatitur një listë më të gjitha pajisjet e nevojshme, të cilën ia kam dhënë kolegëve , por deri me tani nuk janë siguruar, as edhe ato me te domosdoshmet qe shërbejnë për evidentimin e fakteve në terren. A mos vallë edhe këtu bëhet fjalë për keqpërdorime?!

Shkeljet në marrjen e vendimeve dhe përfaqësimin e KHAIA-së

Një tjetër e metë e këtij Autoriteti ka qenë edhe fakti, se dy anëtarët, Kreshnik e Arben Gashi, kanë qenë miq qysh nga shkolla e mesme, dhe kur kihet parasysh, se vendimet në komisione merren me shumicë votash, atëherë këta të dy e bënin shumicën, çfarë ua mundësonte atyre t'i marrin të gjitha vendimet pa pasur nevojë as të më pyesnin mua! Dhe kështu këta të dy bën çfarë deshën, e unë mësoja se çfarë po ndodhte në KHAIA veten nga burimet e rastit (për këtë posedoj dheshmi te mjaftueshme!). Po meqë, dy koleget e mi atëkohë e bënin shumicën, edhe pse nuk ishte legjitime të merrnin vendime në mënyrën e tillë, të paktën pa u konsultuar me mua, unë thjesht kam heshtur, sepse Kreshniku ma kishte bërë me dije se ai e kishte përkrahjen nga politika! Një praktik të tillë unë u mundova ta ndërpres, pas kohës kur KHAIA kishte mbetur pa kryesues. Iu drejtova me eMaile kolegut tim, Arben Gashit, duke e këshilluar, se si ne duhet të komunikojmë dhe veprojmë derisa të caktohet Kryesuesi i ri. Për t'iu shmangur keqkuptimit, fillimisht ia lash Arben Gashit, me kërkesën e tij, qe ai ta organizojë dhe udhëheqë rastin e parë të përfaqësimit të KHAIA-së, qe ishte takimi me Koleget tan nga Hungaria, të cilët erdhën për vizitë në Prishtinë. Takim shkoi mirë! Fatkeqësisht, nuk kaloj as një javë, kur unë nga gazetat e mësove, se Arben Gashi e kishte përfaqësuar KHAIA-në në organizimin e një tryeze për vizitën e Sekretariatit të South East Europe Transport Observatory (SEETO) me datën 1 prill 2014. Kjo mua ma beri të çartë, se Arben Gashi nuk ka hekur dorë nga praktika e vjetër, e për çfarë unë e ngrita shqetësimin tim pran Stafit të Kryeministrit, Zyrës Ligjore dhe vet kolegut. E kolegu im, Arben Gashi, në vend se të arsyetohej e të kërkonte falje, u tregua shumë i ashpër dhe arrogant! Më vonë kuptova, se Arben Gashi në maj të 2014-tës kishte raportuar edhe në Komisionin Parlamentarë për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, dhe poashtu kishte shkuar në Bruksel me grupin qeveritar për të raportuar për KHAIA-në në lidhje me MSA-në. Mua tani nuk me kishte mbetur gjë tjetër, veçse t'i drejtohem Zyrës Ligjore me kërkesën për interpretim ligjor në lidhje me veprimet e Arben Gashit, çfarë edhe e bëra, por edhe pse gojarisht me është thënë, se kolegu im ka bërë keqpërdorim të detyrës zyrtare, deri me tani nuk kam marr përgjigje me shkrim. Arben Gashi, prapë ka vazhduar ta përfaqësoi KHAIA-në edhe ne shumë vizita e takime, deri me sot (datën 17-19 shtator ka udhëtuar për në Bruksel në emër të KHAIA-së). Se për çfarë dhe si ai e ka prezantuar KHAIA-në e këto takime, unë nuk e mësova asnjëherë!

Ndërhyrja nga Autoriteti i Aviacionit Civil (AACK) gjegjësisht Zëvendës Drejtorit Gjeneral, Kreshnik Gashit, në pavarësinë e KHAIA-së

Unë më vonë kuptova, se edhe ish-kolegu, i cili nga 19 shkurti kishte kaluar në Autoritetin e Aviacionit Civil, Kreshnik Gashi, përmes mikut të tij Arben Gasit, vazhdonte ta ruante ndikimin në KHAIA, e çfarë është me e keqja, ai edhe pas largimit nga KHAIA vazhdonte të trajtonte në media tema të cilat nuk ishin me kompetencë e tij (konflikt interesi), dhe vazhdonte të merrte pjesë në emër të KHAIA-së, çfarë cilësohet si ndërhyrje direkt në pavarësinë e KHAIA-së, i cili

edhe me ligj është tërësisht i pavarur (posedoj dëshmi!), ç'farë lirisht mund të cilësohet edhe si vepër penale (Posedoj dëshmi!).

Kreshnike Arben Gashi kanë pasur mbështetje nga jashtë

Unë jam i bindur, se kolegu im Arben Gashi nuk do mund t'i realizonte të gjitha ato qe u përendën më lartë pa ndihmën dhe përkrahjen e dikujt nga jashtë KHAIA-së, e për këtë gjë përgjegjësia për pengimin e funksionimit të KHAIA-së bie edhe mbi ta, kushdo çofshin ata!

Shkelja ligjore si rezultat i zvarritjes së caktimit të Kryesuesit të KHAIA-së

Unë vazhdimisht dhe në forma të ndryshme jam munduar t'i mbaj të informuar të gjithë udhëheqësit në institucionet përkatëse në ZKM dhe ta ngriti çështjen e KHAIA-së në tavolinat e tyre të punës.

Poashtu fakti, se KHAIA ka ngelur qe prej 19 shkurtit pa Kryesues, përderisa me ligjin nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës edhe me e qartë është rregullorja nr. 06/2010 për procedurat e emërimit në pozita të larta drejtuese në shërbimin civil të Republikës së Kosovës, thuhet, se: *"Asnjë pozitë e lart drejtuese nuk duhet te plotësohet me ushtrues detyre për më shumë se 3 muaj"*, është edhe një dëshmi më shumë, për ta kuptuar, se këtu vërtet kemi të bëjmë me mungesën e gatishmërisë së organeve përgjegjëse për ta zhvilluar këtë autoritet.

Kërkohet sqarim nga Kreshnik e Arben Gashi për disa ngjarje, si p.sh. arrestimi në Bruksel

Gjatë këtyre viteve kam par e dëgjuar një varg gjërash të pakëndshme në adresë të KHAIA-së, për të cilat Kreshnik e Arben Gashi do të duhej te jepnin sqarime, si p.sh.: Unë kam mësuar për rastin, kur Kreshnik Gashi (Kryesuesi) në një përfaqësim të KHAIA-së në vitin 2012, mu në mes të një kokteji në pranin e të gjithë drejtoreve të autoriteteve për hetimin e aksidenteve ajrore të shteteve evropiane, arrestohet. Se për çfarë ai në të vërtet ishte arrestuar, dhe për çfarë arsye disa kohë me vonë, hetuesit e EULEX-it e kanë bastisur zyrën e tij, nuk e mësova kurrë?! Po qarkullojnë fjalët, se edhe Arben Gashi është duke u intervistuar rregullisht nga Hetuesia! Pyetja për ta do të ishte: Se a është e vërtetë kjo, dhe se për çfarë arsye këta dy persona janë duke u hetuar?

Rimandatimi i anëtarëve të KHAIA-së

Kryesuesit të KHAIA-së, Kreshnik Gashit, iu krijua një pozitë enkas për te në Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës (AACK). Ai u emërua aty Zëvendës i Drejtorit Gjeneral. E poashtu dikush u kujdes, qe edhe Arben Gashit t'i vazhdohej mandati, para se t'i skadonte.

Pasi qe unë isha emëruar disa muaj më vonë Anëtar i KHAIA-së, edhe mandati im me skadoi tek me 16 nëntor të vitit 2014. Siç kam mësuar, Brukseli kishte dhënë vërejtje për zhvillimet në KHAIA, dhe diku nga fundi i vitit 2014 u shpall edhe konkursi për pozitën e lirë, Inspektor i Inxhinierisë Aeronautike. Procesi i shpalljes se konkursit u zhvillua tërësisht prapa shpinës sime, dhe unë rreth ecurive mësoja vetëm nga media. Për këtë pozitë kishte konkurruar një numër i konsiderueshëm, por unë prej tyre dua ta veçoj Bedrije Hajdarin, një femër kosovare me profesion pilote profesionale dhe inxhiniere e transportit ajrore. Bedria me përgatitjen e saj profesionale i plotëson të gjitha kushtet për të qenë një anëtare e denjë e këtij Autoriteti.

Për kundër pritjeve, që në KHAIA te emërohej anëtari i ri dhe njëkohësisht, te riemërohesha unë dhe te caktohej kryesuesi i ri, një gjë e tillë nuk ndodhi deri me sot.

Nga përvoja ime, krejt kjo me bënë të dyshoj, se edhe këtë herë dikush nuk arriti t'i realizoj qëllimet e tij për të futur në KHAIA njerëz pa arsimimin dhe përvojën e duhur.

Te nderuar kolege, nga e gjithë kjo qe u trajtua, mund të kuptojmë, se me këtë autoritet është abuzuar qe nga formimi i tij. Dhe populli thotë: "Ç'farë të mbjellësh, do të korrësh"

Unë jam i bindur, se shqiptaret do të shpëtojnë nga të qenurit viktimë, vetëm atëherë kur të kenë ndërtuar institucione të mirëfillta e funksionale, pra te kenë një shtet te organizuar mirë ete ndërtuar mbi vlera!

Kjo është edhe motoja, të cilën unë e kam ndjekur, qe nga dita e parë e marrjes së detyrës anëtar i KHAIA-së e deri me sot!

Mbes me bindjen, se qeveria e re do të punoj drejt në drejtim të ndërtimit dhe funksionalizimit të institucioneve shtetërore, e kjo ta rris zhvillimin ekonomik, shoqërorë dhe sigurinë në Republikën e Kosovës!

Ju falënderoj për mirëkuptimin dhe angazhimin tuaj në drejtim të funksionalizimit të KHAIA-së!

Me respekt
Avdi J. Shala
Hetues i Sigurisë dhe Aksidenteve Ajrore
Komisioni për Hetimin e Aksidenteve dhe Incidenteve Aeronautike (KHAIA)
Zyra e Kryeministrit të Republikës së Kosovës